Republika e Kosovës
Republik of Kosovo
Republika Kosova

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti

DREJTORIA PËR FINANCA, EKONOMI DHE ZHVILLIM

♦ SEKTORI I TATIM NË PRONË

NJOFTIM PUBLIK

THIRRJE PËR QYTETARËT ME OBLIGIME TË PAPAGUARA TË TATIMIT NË PRONË

Sektori i Tatimit në Pronë i Komunës së Vitisë u bën thirrje të gjithë qytetarëve dhe tatimpaguesve, të cilët kanë obligime të papaguara të Tatimit në Pronë në vlerë mbi ***300.00 €,*** *që të paraqiten në Zyrën e Tatimit në Pronë për të verifikuar gjendjen e obligimeve të tyre dhe për të ndërmarrë veprimet e nevojshme për shlyerjen e borxheve. Në veçanti, ftohen qytetarët që të kontrollojnë gjendjen tatimore të parcelave dhe pronave të paluajtshme që i posedojnë, përfshirë edhe ato prona të cilat ende figurojnë në emër të prindërve, gjyshërve apo anëtarëve të tjerë të familjes, e të cilat kanë obligime të papaguara të Tatimit në Pronë.*

Me qëllim të shmangies së procedurave të mëtejshme të inkasimit të detyrueshëm dhe pasojave ligjore, qytetarët inkurajohen që të paraqiten sa më parë në Zyrën e Tatimit në Pronë, ku kanë mundësi të informohen për gjendjen e borxhit dhe të lidhin marrëveshje me Komunën e Vitisë për pagesën e obligimeve me këste, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara.
Ju rikujtojmë se ndaj tatimpaguesve të cilët nuk i përmbushin obligimet e tyre tatimore mund të ndërmerren masa ligjore për inkasimin e detyrueshëm, të cilat mund të përfshijnë:

- *Vendosjen e gjobave dhe ndëshkimeve përkatëse;*
- *Bllokimin e llogarive bankare;*
- *Vendosjen e barrës tatimore mbi pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme;*
- *Konfiskimin e pasurisë përmes procedurave ligjore;*
- *Kufizime të tjera ligjore, përfshirë masat lidhur me kalimin e kufirit, kur ato janë të zbatueshme sipas legjislacionit në fuqi.*

Andaj, lusim të gjithë qytetarët që kanë obligime të papaguara mbi 300.00 € të mos e neglizhojnë këtë çështje, por të paraqiten me kohë në Zyrën e Tatimit në Pronë për të verifikuar borxhin dhe për të gjetur një zgjidhje përmes marrëveshjes së pagesës me këste.

Përmbushja me kohë e obligimeve tatimore është përgjegjësi ligjore dhe kontribut i drejtpërdrejtë në zhvillimin e Komunës së Vitisë dhe në realizimin e projekteve në interes të të gjithë qytetarëve.
Për informata shtesë dhe lidhjen e marrëveshjeve për pagesë, qytetarët mund të drejtohen në:

Zyrën e Tatimit në Pronë
Komuna e Vitisë.